Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-418
Datë: 30.07.2018

Në mbështetje të nenit 18 pika 1 dhe nenit 19 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare dhe nenit 23 me pikat 1, 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Vendimit nr. 334/01 të datës 29.06.2018 si dhe Vendimit nr. 01/331 të datës 13.10.2017, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 17.07.2018 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi për institucionin N.SH. KAS (Qendra e Bukurisë KAS) për të gjitha lokacionet, në Prishtinë, me adresë Rruga Bajram Kelmendi p.n, në Ferizaj, me adresë Rruga 12 Qershori, në Gjilan, me adresë Rruga Mulla Idrizi dhe në Kamenicë, me adresë Rruga Fehmi Agani, për të gjitha kualifikimet:
   - **1.1. Parukier/Parukiere, Niveli III sipas KKK me 120 kredi të AAP;**
   - **1.2. Grimer/Grimere, Niveli III sipas KKK me 38 kredi të AAP;**
   - **1.3. Pedikyrist/Pedikyriste, Niveli III sipas KKK me 6 kredi të AAP; dhe**
   - **1.4. Manikyrist/Manikyriste, Niveli III sipas KKK me 6 kredi të AAP.**

Arsyetim

Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet e raporteve të ekspertëve të monitorimit si dhe kushteve të caktuara për plotësim nga KD i AKK-së.
Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

3. Vendimi u dërgohet:
   - N.SH. KAS (Qendra e Bukurisë KAS);
   - AKK.

Kryetari i KD së AKK
Bedri Xhafa